



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 20 dhjetor 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën Urgjente për Lëshimin e një Urdhri për Administratoren
në lidhje me Zbatimin e Vendimit F01977**

Zyrës së Prokurorit të Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 3(5), 21, 34(12), 40 dhe 41 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji ") dhe rregullave 23(7) dhe 56(6) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), dhe neneve 8 dhe 9 të Udhëzuesit të Punës të Zyrës Administrative në lidhje me të paraburgosurit: Ankesat,¹ lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 1 dhjetor 2023, Trupi Gjykues lëshoi një vendim të mëtejshëm mbi kërkesën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS") për modifikimin e kushteve të paraburgimit të Rexhep Selimit ("z. Selimi"), Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit ("Vendimi").²

2. Më 7 dhjetor 2023, Administratorja dorëzoi një përditësim në lidhje me zbatimin e Vendimit të Trupit Gjykues.³ Shtojca 1 e përditësimit të Administratores përmban një letër të përgatitur nga Administratorja me të cilën njoftohen mbrojtësit e, ndër të tjerë, z. Selimi, për masat e marra në bazë të Vendimit të Trupit Gjykues ("Letra e Administratores").⁴

3. Më 11 dhjetor 2023, Mbrojtja e Selimit i dorëzoi Trupit Gjykues një kërkesë për lëshimin e një urdhri drejtuar Administratores për ndryshimin e masave të

¹ KSC-BD-11-Rev1, 23 shtator 2020.

² F01977, Trupi Gjykues, *Vendim i Mëtejshëm mbi Kërkesën Urgjente të Prokurorisë për Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit*, 1 dhjetor 2023.

³ F01989, Administratorja, *Përditësim i Zyrës Administrative në lidhje me Zbatimin e Vendimit të Mëtejshëm të Trupit Gjykues II mbi Kërkesën Urgjente të Prokurorisë për Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit*, 7 dhjetor 2023, me Shtojcën 1, konfidenciale, dhe Shtojcat 2, 3 dhe 4, konfidenciale.

⁴ F01989/A01, Administratorja, *Shtojca 1 e Përditësimit të Zyrës Administrative në lidhje me Zbatimin e Vendimit të Mëtejshëm të Trupit Gjykues II mbi Kërkesën Urgjente të Prokurorisë për Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit*, 7 dhjetor 2023, konfidenciale.

marra në zbatim të Vendimit të përshkruara në Letrën e Administratores (“Kërkesa”).⁵

4. Më 14 dhjetor 2023, Trupi Gjykses bëri të ditur se të gjitha përgjigjet ndaj Kërkesës duhej të dorëzoheshin deri më 18 dhjetor 2023 dhe se nuk do të lejohej të dorëzoheshin kundërpërgjigje.⁶

5. Më 15 dhe 18 dhjetor 2023, Mbrojtja e Hashim Thaçit (“z. Thaçi” dhe “Mbrojtja e Thaçit”) dhe Mbrojtja e Kadri Veselit (“z. Veseli” dhe “Mbrojtja e Veselit”) iu bashkuan Kërkesës (“Kërkesa për Bashkim e Thaçit”, “Kërkesa për Bashkim e Veselit”, bashkërisht, “Kërkesat për Bashkim”).⁷

II. PARASHTRIME

6. Mbrojtja e Selimit parashtron se Administratorja e ka zbatuar Vendimin e Trupit Gjykses në mënyrë arbitrare, duke tejkalluar diskrecionin që i është dhënë dhe dispozitat e përmendura në Vendimin e Trupit Gjykses.⁸ Mbrojtja e Selimit parashtron se, në një mënyrë të palejueshme, Administratorja: (i) po kufizon thirrjet telefonike të privileguara të z Selimi me bashkëshorten dhe fëmijët e tij;⁹ (ii) po kufizon kohëzgjatjen e vizitave jo të privileguara;¹⁰ (iii) po redukton

⁵ F02002, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë Urgjente e Mbrojtjes së Selimit Drejtuar Trupit Gjykses për Lëshimin e një Urdhri për Administratoren në lidhje me Zbatimin e Vendimit F01977*, 11 dhjetor 2023, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 14 dhjetor 2023, F02002/RED.

⁶ Korrespondenca 398.

⁷ F02017, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Bashkim me Kërkesën Urgjente të Mbrojtjes së Selimit Drejtuar Trupit Gjykses për Lëshimin e një Urdhri për Administratoren në lidhje me Zbatimin e Vendimit F01977 (F02002)*, 15 dhjetor 2023, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 20 dhjetor 2023, F02017/RED); F02021, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Bashkim me Kërkesën Urgjente të Mbrojtjes së Selimit Drejtuar Trupit Gjykses për Lëshimin e një Urdhri për Administratoren në lidhje me Zbatimin e Vendimit F01977 (F02002)*, 18 dhjetor 2023, konfidencial.

⁸ Kërkesa, para. 1-3.

⁹ Kërkesa, para. 4-9.

¹⁰ Kërkesa, para. 10-14.

kohëzgjatjen e vizitave private me familjarët,¹¹ dhe (iv) po imponon një sistem të ngurtë për organizimin e vizitave.¹²

7. Mbrojtja e Selimit parashtron se nevojitet një ndërhyrje gjyqësore urgjente për të garantuar zbatimin e drejtë dhe proporcional të Vendimit të Trupit Gjyqësor.¹³ Mbrojtja e Selimit kërkon që Trupi Gjyqësor të lëshojë një urdhër me të cilin Administratorja të udhëzohet të respektojë Vendimin e Trupit Gjyqësor gjatë zbatimit të kushteve të modifikuara të paraburgimit të përshkruara në Vendim.¹⁴ Konkretisht, Mbrojtja e Selimit kërkon që Trupi Gjyqësor të urdhërojë Administratoren të ndryshojë zbatimin e Vendimit në një mënyrë të tillë që: (i) i mundëson z. Selimi të kryejë thirrje telefonike me bashkëshorten dhe fëmijët e tij nga objekti i paraburgimit, pa kufizime të mëtejshme; (ii) shton kohëzgjatjen e vizitave personale jo të privileguara nga 40 minuta në 2 orë për vizitë; (iii) shton kohëzgjatjen e vizitave private nga gjysmë dite në një ditë të plotë; dhe (iv) i lejon z. Selimi të planifikojë vizita në mënyrë më elastike dhe me më pak njoftim paraprak.¹⁵ Mbrojtja e Selimit gjithashtu kërkon që Trupi Gjyqësor të planifikojë mbajtjen e një konference mbi ecurinë e çështjes me Administratoren për t'u dhënë zgjidhje aspekteve për të cilat janë paraqitur këto pretendime.¹⁶

8. Si Mbrojtja e Thaçit ashtu dhe Mbrojtja e Veselit i janë bashkuar Kërkesës, përveç pjesës që ka të bëjë me kërkesën për mbajtjen e konferencës për ecurinë e çështjes.¹⁷ Mbrojtja e Thaçit dhe e Veselit kërkojnë që Trupi Gjyqësor të urdhërojë Administratoren të ndryshojë zbatimin e Vendimit në një mënyrë të tillë që: (i) lejon z. Thaçi dhe z. Veseli të kryejnë thirrje telefonike me bashkëshortet dhe fëmijët e tyre nga Njësia e Paraburgimit, pa kufizime të mëtejshme; (ii) shton

¹¹ Kërkesa, para. 15-18.

¹² Kërkesa, para. 19-23.

¹³ Kërkesa, para. 3, 24.

¹⁴ Kërkesa, para. 1.

¹⁵ Kërkesa, para. 27(i).

¹⁶ Kërkesa, para. 27(ii).

¹⁷ Kërkesa për Bashkim e Thaçit, para. 2; Kërkesa për Bashkim e Veselit, para. 1-3.

kohëzgjatjen e vizitave private jo të privileguara nga 40 minuta në 2 orë për vizitë; (iii) shton kohëzgjatjen e vizitave private nga gjysmë dite në një ditë të plotë; dhe (iv) u lejon z. Thaçi dhe z. Veseli të planifikojnë vizita me më shumë fleksibilitet dhe me më pak njoftim paraprak.¹⁸

9. Mbrojtja e Thaçit gjithashtu parashtron se: (i) kufizimet e vendosura i heqin z. Thaçi mundësinë për të gëzuar në mënyrë të njëmendtë të drejtën e tij për jetë familjare;¹⁹ (ii) nuk janë dhënë arsye thelbësore për të përligjur kufizimet e përcaktuara nga Administratorja në lidhje me thirrjet telefonike të z. Thaçi me anëtarë të familjes së ngushtë;²⁰ (iii) lejimi i thirrjeve telefonike të z. Thaçi me anëtarë të familjes së ngushtë të tij në datat dhe orët e zgjedhura prej tij do të ishte në përputhje me Vendimin;²¹ (iv) nevojitet një fleksibilitet më i madh në përcaktimin e kohëzgjatjes dhe planifikimin e vizitave private të z. Thaçi;²² dhe (v) nuk është treguar lidhja e masave të vendosura nga Administratorja me të cilat kufizohen kontaktet telefonike dhe vizitat private me familjarë të z. Thaçi, me qëllimin legjitim të parandalimit të ndërhyrjeve.²³

10. Mbrojtja e Veselit gjithashtu kërkon: (i) të jepet një sqarim që fëmijët e mitur të z. Veseli, të cilët ende jetojnë në shtëpi, të lejohen të marrin pjesë në komunikimet telefonike së bashku me bashkëshorten e z. Veseli;²⁴ dhe (ii) të tregohet kujdes më i madh për të siguruar që planifikimi i vizitave personale me familjarë të mos ndikojë në shkollimin e fëmijëve të z. Veseli.²⁵

¹⁸ Kërkesa për Bashkim e Thaçit, para. 1; Kërkesa për Bashkim e Veselit, para. 1-2.

¹⁹ Kërkesa për Bashkim e Thaçit, para. 4-5.

²⁰ Kërkesa për Bashkim e Thaçit, para. 6.

²¹ Kërkesa për Bashkim e Thaçit, para. 6.

²² Kërkesa për Bashkim e Thaçit, para. 7.

²³ Kërkesa për Bashkim e Thaçit, para. 8.

²⁴ Kërkesa për Bashkim e Veselit, para. 5.

²⁵ Kërkesa për Bashkim e Veselit, para. 6.

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

11. Sipas nenit 40(2) dhe (6) të Ligjit dhe rregullës 116(1) të Rregullores, Trupi Gjykses merr vazhdimisht të gjitha masat e nevojshme për lehtësimin e kryerjes së drejtë dhe të shpejtë të gjykimit dhe për mbrojtjen e të akuzuarit, dëshmitarëve dhe viktimave.

12. Në bazë të rregullave 56, 57(2) dhe 116(4)(d), me qëllim mbrojtjen e dëshmitarëve apo viktimave, të informacionit konfidencial apo të integritetit të procesit, Trupi Gjykses mund të nxjerrë vendim lidhur me kushtet e paraburgimit dhe çështje që kanë lidhje me paraburgimin, ndër to dhe vendim mbi përcaktimin e kufizimeve të nevojshme dhe proporcionale mbi komunikimet e të paraburgosurit.

13. Sipas nenit 8(2) të Udhëzuesit të Punës të Zyrës Administrative në lidhje me të paraburgosurit: Ankesat (“Udhëzuesi i Punës për Ankesat”):²⁶

Nëse Administratori nxjerr vendimin e parë me shkrim lidhur me trajtimin dhe/ose kushtet e paraburgimit për një të paraburgosur, sidomos nëse vendimi është për [. . .] kufizimin e vizitave dhe komunikimeve [. . .], i paraburgosuri mund t'i parashtrorë ankesë drejtpërsëdrejti Administratorit kundër këtij vendimi, ku i kërkon rishikimin e vendimit, brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga marrja e vendimit me shkrim të Administratorit.

14. Në bazë të nenit 9 të Udhëzuesit të Punës për Ankesat, një i paraburgosur ka të drejtë të kërkorë rishikim gjyqsor të vendimit të Administratorit, duke parashtruar një kërkesë për rishikim gjyqsor brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga marrja e vendimit me shkrim të Administratorit.

15. Në Vendimin e vet, Trupi Gjykses parashikoi të drejtën për rishikim gjyqsor të vendimit të Administratores për refuzimin e kërkesave për vizita personale ose vizita me videolidhje, komunikime me telefon, ose për zbatimin e mbikëqyrjes aktive të vizitave me videolidhje. Ankesa të tilla mund t'i paraqiten drejtpërdrejt

²⁶ KSC-BC-11/Rev1, 23 shtator 2020.

Trupit Gjykses brenda shtatë ditësh.²⁷ Trupi Gjykses gjithashtu vendosi afate konkrete në lidhje me disa detyrime për raportim të Administratores.²⁸

IV. DISKUTIM

16. Fillimisht, Trupi Gjykses thekson se Kërkesa për Bashkim e Veselit me Kërkesën u dorëzua dy orë pas përfundimit të afatit të përcaktuar nga Trupi Gjykses.²⁹ Në bazë të rregullës 9(5)(b), duke pasur parasysh rëndësinë e problemeve të ngritura dhe faktin se palët e tjera nuk dëmtohen, Trupi Gjykses do ta trajtojë Kërkesën për Bashkim të Veselit si parashtrim të vlefshëm.

17. Trupi Gjykses thekson se, varësisht prej afateve të shkurtuara të përcaktuara në Vendimin e Trupit Gjykses, Udhëzuesi i Punës për Ankesat përcakton procedurën për parashtrimin e ankesës ndaj çdo vendimi të marrë nga Administratorja në lidhje me kushtet e paraburgimit. Sipas Udhëzuesit të Punës për Ankesat, dhe sikurse urdhërohet në Vendimin e Trupit Gjykses, një ankesë e tillë duhet t'i parashtrohet drejtpërdrejt Administratores. Përveç nëse përcaktohet ndryshe në Vendimin e Trupit Gjykses, i paraburgosuri ka 30 ditë kalendarike në dispozicion për dorëzimin e ankesës, pas marrjes së vendimit me shkrim të Administratores.³⁰ Pasi i paraqitet ankesa, Administratorja konfirmon marrjen e saj dhe bën të ditura arsyet për të rishikuar ose refuzuar rishikimin e vendimit të parë të saj. Trupi Gjykses gjithashtu thekson se, përveç nëse përcaktohet ndryshe në Vendimin e Trupit Gjykses, i paraburgosuri ka të drejtë të kërkojë rishikim gjyqësor brenda 30 ditësh nga marrja e vendimit të Administratores në lidhje me rishikimin.³¹

²⁷ Vendimi, para. 53, 69.

²⁸ Vendimi, para. 55, 58, 78.

²⁹ *Shih* Korrespondencën 398; Kërkesën për Bashkim të Veselit.

³⁰ Udhëzuesi i Punës për Ankesat, neni 8(2).

³¹ Udhëzuesi i Punës për Ankesat, neni 9(1).

18. Në këtë rast, Mbrojtja e Selimit, Thaçit dhe Veselit kërkojnë modifikimin e kushteve të përcaktuara në Letrën e Administratores nëpërmjet lëshimit të një urdhri nga Trupi Gjykses. Trupi Gjykses gjykon se një kërkesë e tillë përbën “ankesë”, të cilat trajtohen në Udhëzuesin e Punës për Ankesat, i cili përcakton procedurën sipas së cilës një ankesë ndaj kufizimeve të vendosura nga Administratori në lidhje me vizitat dhe/ose komunikimet duhet fillimisht t’i dërgohet Administratorit dhe më pas Trupit Gjykses.³² Rrjedhimisht, procedura e zbatuar nga Mbrojtja nuk përputhet me procedurën e përcaktuar në Udhëzuesin e Punës për Ankesat.³³ Ajo është gjithashtu e parakohshme.

19. Gjithashtu, Trupi Gjykses thekson se i ka dhënë Administratores diskrecion të gjerë për të përshtatur dhe zbatuar e Vendimit të Trupit Gjykses në një mënyrë që është në përputhje me kushtet e Vendimit, të drejtat e të akuzuarve dhe aspektet praktike që lidhen me zbatimin efektiv të Vendimit. Rrjedhimisht, çdo ankesë ndaj zbatimit të Vendimit të Trupit Gjykses do të duhej të vërtetonte se Administratorja ka tejkalar diskrecionin që i ka dhënë Trupi Gjykses për zbatimin e Vendimit të tij dhe/ose e ka ushtruar këtë diskrecion në mënyrë arbitrare. Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se fakti që kushtet e përcaktuara për vizitat ose kontaktet me botën e jashtme janë bërë më të rrepta për të akuzuarit, ose që këto vizita ose kontakte do të bëhen më të rralla ose më të shkurtra nuk është, në vetvete, tregues i arbitraritetit nga ana e Administratores. Këto janë pasoja të Vendimit të Trupit Gjykses dhe të rrethanave që çuan në miratimin e atij Vendimi.

³² Në Kërkesën e saj, Mbrojtja e Selimit nuk thotë se fillimisht ia ka parashtruar atë Administratores me kërkesën për rishikimin e kushteve të paraburgimit, para se t’ia paraqiste Trupit Gjykses dhe këtë nuk e thotë as Mbrojtja e Thaçit dhe Veselit në Kërkesat e tyre për Bashkim me Kërkesën.

³³ Trupi Gjykses thekson se Vendimi përcakton gjithashtu procedurën sipas së cilës i paraburgosuri mund të kërkojë rishikim gjyqësor të drejtpërdrejtë prej Trupit Gjykses në lidhje me disa vendime të kufizuara të Administratorit (*shih* Vendimin, para. 53, 69). Kushtet e përcaktuara në Letrën e Administratores nuk përbëjnë vendime të tilla.

20. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses konstaton se Kërkesa dhe Kërkesat për Bashkim me të, nuk i janë paraqitur Trupit Gjykses në përputhje me procedurën e përcaktuar dhe janë të parakohshme.

V. VENDIM

21. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses **RRËZON** Kërkesën dhe Kërkesat për Bashkim me të.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E mërkurë, 20 dhjetor 2023

Në Hagë, Holandë.